

Në bazë të nenit 55 alinea 1 nga Ligji për organizimin dhe punën e organeve të qeverisjes shtetërore („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë ” nr . 58/00, 44/02, 82/08, 167/10 dhe 51/11), dhe „ dhe („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut “ 96/19 dhe 110/19) si dhe në bazë të nenit 50 alinea 6 nga Ligji për arsim fillor („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut “ nr. 161/2019) Mnistri për Arsimit dhe Shkencë e solli programin e shkurtuar mësimor për lëndën *Gjuhë angleze për klasën e IV (katërt)* të arsimit fillor nëntëvjeçar për vitin shkollor 2020/2021.

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS
BYROJA E ZHVILLIMIT TË ARSIMIT



Program i shkurtuar mësimor

GJUHË ANGLEZE

Për klasë të IV (katërt)

Arsimi fillor nëntëvjeçar

Shkup, shtator 2020

1. Hyrje

Programi i shkurtuar mësimor nga lënda mësimore *Gjuhë angleze* bazohet në qëllimet/ rezultatet e pritura të parapara me programin mësimor për lëndën mësimore i cili realizohet si i rregullt në përputhje me planet mësimore.

Me programin e shkurtuar vërtetohen temat e caktuara të cilat do të duhen të realizohen për 159 ditë mësimore, me kohëzgjatje prej 30 min, gjatë së cilës duhet patur kujdes fondi i paraparë në kuadër të programit të rregullt, konkretisht me 3 orë në javë parashihen 96 orë në programin e shkurtuar.

Arsimtari gjatë planifikimit dhe realizimit të njësive mësimore nga programi i shkurtuar mësimor niset nga qëllimet /rezultatet e pritura, nocionet e caktuara, metodat dhe aktivitetet të parashikuara në programin e rregullt mësimor.

2. Pasqyrë e temave¹

TEMA 1. BOTA IME E VOGËL: FAMILJA, SHTËPIA, MIQTË (24 orë)

TEMA 2. BOTA IME E JASHTME: SHKOLLA, INTERESIMI, AKTIVITETE TË LIRA (24 orë)

TEMA 3. LAGJJA JONË, QYTETI JONË, BOTA JONË (24 orë)

TEMA 4. PLANETI JONË, SHËNDETI JONË, ARDHMËRIA JONË (24 orë)

Duke pasur parasysh fondin e përgjithshëm të orëve të paraparë me programin e shkurtuar mësimor, këshillohet çasje holistike gjatë të mësuarit të gjuhës në kuadër të temave të dhëna të cilat përfshijnë tipa të ndryshëm të orëve dhe që përfshijnë jo vetëm njësi leksikore dhe struktura gramatikore por edhe funksione gjuhësore të parashikuara, të cilat bashkarisht do të ndikojnë në përvetësim efektiv të shkathtësive gjuhësore (dëgjim dhe të kuptuarit e leximit, tëshprehurit dhe të shkruarit)dhe do të mundësojnë zhvillim të plotë të kompetencës komunikative tek nxënësit.

Gjithashtu, këshillohet prezantim cilësor i përmbajtjeve të reja mësimore me implementim të aktiviteteve të parashikuara për përforsim të të njëjtave.

Multikulturalizmi, përmbajtjet interkulturore dhe shkrimleximi mediatik janë pjesë kompatible e mësimit të gjuhës angleze si gjuhë e huaj dhe përfshirja e tyre në pjesën më të madhe të përmbajtjeve mësimore mundëson realizimin e saj konkret dhe zbatim praktik të njohurive dhe shkathtësive të fituara në mënyrën bashkëkohore të komunikimit dhe stilit të të jetuarit.

¹ Në lidhje me temat e dhëna dhe orët e ofruara për secilën prej tyre, mësmdhënësi bën vlerësim të mënyrës dhe gjërësisë gjatë përpunimit të secilës temë veçmas, duke marrë në konsideratë çasjen intgruese dhe balansuese gjatë të mësuarit të të të gjitha elementeve gjuhësore, në përputhje me mundësitë e nxënësve dhe nevojave të tyre..

3. Rekomandime didaktike

Pikënisje bazë për realizimin e programit të shkurtuar mësimor për lëndën *Gjuhë angleze* është programi i rregullt mësimor (rezultatet nga të mësuarit, përmbajtje dhe nocione, aktivitetet dhe metodat e propozuara si dhe standartet për notim).

Gjatë realizimit të programit të shkurtuar, mësimi i gjuhës angleze si gjuhë e huaj realizohet sipas çasjes së integruar pa e ndarë në komponenta dhe shkathtësi të caktuara gjuhësore në raport me numrin e planifikuar të orëve. Me rëndësi është të theksohet se të mësuarit e gjuhës angleze nuk bazohet në elemente të veçanta gjuhësore siç janë leksiku, gramatika dhe funksionet gjuhësore, por nevojitet të mësuarit e balansuar dhe integruar të të gjithë këtyre elementeve në kontekst. Në veçanti gramatika nuk duhet të mësohet me memorim (të mbajtur mend) të rregullave dhe definicioneve për përdorim, por kontekstualisht (me shembuj), që të kuptohet rëndësia dhe zbatimi autentik në gjuhë.

Qëllimet në programin mësimor për klasë të katërt janë pjesë e qëllimeve të parashikuara në ciklin e dytë zhvillimor të mësimin të gjuhës së huaj (IV –VI) në të cilin parashikohet nxënësit të arrijnë bazën përgatitore A1 për zotërim të gjuhës, duke përparuar nga klasa në kasë duke e zmadhuar gradualisht numrin e njësisve leksikore, llojet e funksioneve gjuhësore dhe vështirësitë e figurave gramatikore.

Kjo do të thotë përqëndrim i njëjtë në shkathtësit gjuhësore në nivel receptiv dhe produktiv, siç janë: dëgjim me të kuptuar, lexim me të kuptuar, të folurit, (interakcion dhe produktion) dhe të shkruarit (interakcion dhe produktion i shkruar), me qëllim që të nxit zhvillim të integruar të kompetencës komunikative.

Mësimi i gjuhës angleze për nxënësit e kësaj moshe bazohet në multisenzorë (vizual, auditiv, taktil etj.) dhe mësimin holistik i cili i përfshin aspektet kognitive, afektive dhe motorike të nxënësve, gjegjësisht mësimdhënësi do t'i integrojë komponentat e ndryshme me çka gjuha do të mësohet në mënyrë funksionale.

Gjatë zgjedhjes së aktiviteteve duhet të merret në konsideratë diferencimi dhe llojllojshmëria e të njëjtëve, me çka duhet të zgjidhen aktivitete të cilat janë përkatëse, të duhura për zhvillimin kronologjik të nxënësve, si dhe me zhvillimin e tyre kognitiv, dmth. aktivitete me të cilat do të tërhiqet vëmendja e nxënësve.

4. Normativi për kuadrin mësimor

Programin e shkurtuar mësimor e realizon mësimdhënësi në pajtueshmëri me normativin për kuadër mësimor i dhënë në programin e rregullt mësimor.

Programin e shkurtuar mësimor për lëndën mësimore *Gjuhë angleze* për klasën e katërt në arsimin fillor nëntëvjeçar për vitin shkollor 2020/2021 e miratoi

Ministër i Arsimit dhe Shkencës

Mila Carovska